

KUVENDI I SHQIPËRISË MIRATON PROJEKTLIGJIN PËR DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NË LIGJIN PËR SIPËRMARRJET E INVESTIMEVE KOLEKTIVE

VËSHTRIM MBI TREGJET

Zhvillimet e Tregut të Sigurimeve në Shqipëri për periudhën janar-shkurt 2016

ZHVILLIME TË TJERA

- Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare organizoi seminarin për industrinë e sigurimeve me temë “Sigurimi i përgjegjësisë profesionale”
- Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare, me mbështetjen e Bankës Botërore, organizoi seancat informuese mbi mundësitë e zgjerimit të sistemit të pensioneve vullnetare në Shqipëri
- Seminar “Mbi standardet ndërkombëtare për aftësinë paguese dhe kapitalin për siguruesit”

INFORMACIONE NDËRKOMBËTARE

- | | | |
|-------------|------------|-----------------|
| ○ Çeki | ○ Poloni | ○ Botim - IOSCO |
| ○ Hungari | ○ Rumani | ○ Botim - EIOPA |
| ○ Mali i Zi | ○ Slloveni | |

EDUKIMI I KONSUMATORIT

Parimet e nivelit të lartë të G20 për mbrojtjen e konsumatorit
(Pjesa e parë)

Mbrojmë Konsumatorët - Promovojmë Tregjet - Zbatojmë Ligjin

Kuvendi i Shqipërisë miraton projektligjin për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin për Sipërmarrjet e Investimeve Kolektive

Kuvendi i Shqipërisë miratoi në datë 31 mars 2016 në seancë plenare projektligjin “Për disa shtesa dhe ndryshime në Ligjin nr. 10198, datë 10.12.2009, “Për sipërmarrjet e investimeve kolektive”.

Ky projektligj u propozua nga Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare dhe më parë u miratua edhe nga Komisioni për Ekonominë dhe Financat i Kuvendit të Shqipërisë.

Procesi i administrimit të riskut është i rëndësishëm për mbrojtjen e investitorëve, nga risqet ndaj të cilave janë të ekspozuar sipërmarrjet e investimeve kolektive, gjatë kryerjes së veprimtarisë së tyre.

Në prezantimin përpara Komisionit për Ekonominë dhe Financat, Znj. Enkeleda Shehi, Drejtore e Përgjithshme Ekzekutive e AMF-së, shpjegoi amendimet e propozuara, ku të pranishëm ishin edhe ekspertë të AMF-së. Këto propozime u bënë duke konsideruar karakteristikat e tregut të letrave me vlerë në Shqipëri, nevojat dhe objektivat e investitorëve aktualë e atyre potencialë të fondeve të investimeve, dinamikën e shpejtë të zhvillimit të tregut të fondeve të investimeve, si edhe nevojën për të përfortuar mbrojtjen e interesave të investitorit. Ndryshimet dhe shtesat në projektligj janë hartuar në kuadër të rekomandimeve të Programit të Vlerësimit të Sektorit Financiar (FSAP) lidhur me industrinë e fondeve të investimit në Shqipëri dhe synojnë forcimin dhe zhvillimin e mëtejshëm të tregut të sipërmarrjeve të investimeve kolektive (SIK) në vend, duke vënë theksin në forcimin e administrimit të risqeve të tregut të fondeve të investimit dhe operatorëve të këtij tregu. Ky proces i administrimit të riskut është i rëndësishëm për mbrojtjen e investitorëve, nga risqet ndaj të cilave janë të ekspozuar sipërmarrjet e investimeve kolektive, gjatë kryerjes së veprimtarisë së tyre.

Amendimet e ligjit konsistojnë në dy elementë:

- Saktësimin e kompetencave të AMF-së për të vendosur rregulla për kuadrin e administrimit të riskut, në funksion të mbrojtjes së interesit të investitorëve; dhe
- Saktësimin e regjimit të pezullimit të shlyerjes dhe shitjes së kuotave, si dhe kompetencave të AMF-së në këtë proces.

Projektligji bën përafrimin edhe me Direktivat Evropiane në fushën e sipërmarrjes së investimeve kolektive “Për koordinimin e ligjeve, rregulloreve dhe dispozitave administrative lidhur me sipërmarrjet për investimet kolektive në letrat me vlerë të transferueshme” (EU - UCITS), të cilat kanë për qëllim harmonizimin e funksionimit dhe mbikëqyrjes së këtyre fondeve.

Zhvillimet e Tregut të Sigurimeve në Shqipëri për periudhën janar-shkurt 2016

Të ardhurat nga primet e shkruara bruto të sigurimit gjatë periudhës janar-shkurt të vitit 2016 arritën vlerën mbi 1.9 miliardë lekë, ose 4.72% më pak se gjatë periudhës janar-shkurt të vitit 2015. Gjatë kësaj periudhe raportuese, numri i kontratave të lidhura të sigurimit arriti në 142,336 me një rritje prej 0.48% krahasuar me periudhën janar-shkurt të vitit 2015.

—○○○—
Sigurimi i detyrueshëm motorik gjatë kësaj periudhe raportuese përbën 61.68% të tregut të sigurimeve.
—○○○—

Një tjetër tregues i ecurisë së tregut, dëmet e paguara bruto, në total, regjistruan një rritje me 17.85% në krahasim me periudhën janar-shkurt të vitit 2015. Pjesa më e madhe e dëmeve të paguara bruto i përket sigurimit motorik me mbi 0.35 miliardë lekë, apo 67.94% të totalit të dëmeve të paguara bruto.

Sigurimi i Jo-Jetës

Sigurimi i Jo-Jetës u ul me 5.54% gjatë periudhës janar-shkurt 2016, krahasuar kjo me të njëjtën periudhë të vitit të kaluar.

Sigurimi i detyrueshëm motorik

Gjatë periudhës janar-shkurt 2016, primet e sigurimit të detyrueshëm motorik vlerësohet të kenë arritur vlerën rreth 1.17 miliardë lekë, duke shënuar një rritje prej 0.54% krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit të kaluar.

Sigurimi i detyrueshëm motorik gjatë kësaj periudhe raportuese përbën 61.68% të tregut të sigurimeve.

Klasa të tjera në sigurimet e Jo-Jetës

Ndër klasat e tjera kryesore të sigurimit të Jo-Jetës veçohen:

- Zjarri, forcat e natyrës dhe dëmtime të tjera në pronë, të cilat zunë 18.61% të tregut të Jo-Jetës;
- Sigurimi i aksidenteve, sigurimi i shëndetit dhe sigurimi i përgjegjësisë të përgjithshme të cilat së bashku zunë 13.44% të tregut të Jo-Jetës.


Sigurimi i Jetës

Gjatë periudhës janar-shkurt 2016, primet e shkruara bruto në sigurimin e Jetës u ulën me 6.98% krahasuar me periudhën janar-shkurt të vitit 2015. Pjesa më e madhe e primeve të shkruara bruto i përket sigurimit “Jetë debitori” e cila përbën 50.43% të sigurimit të Jetës.

Ndarja e tregut të sigurimeve, janar-shkurt 2016

Grafiku më poshtë paraqet ndarjen e volumit total të primeve të shkruara bruto sipas grupeve kryesore.

Pjesa më e madhe e primeve të shkruara bruto i përket sigurimit “Jetë debitori” e cila përbën 50.43% të sigurimit të Jetës.



Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare organizoi seminarin për industrinë e sigurimeve me temë “Sigurimi i përgjegjësisë profesionale”

Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare në bashkëpunim me Agjencinë e Mbikëqyrjes së Sigurimeve të Sllovenisë organizoi në datën 3 mars 2016 seminarin me temë “Sigurimi i Përgjegjësisë Profesionale”. Ky seminar u zhvillua edhe në kuadër të mbështetjes për Qendrën e Edukimit të ngritur pranë AMF-së.

Ekipi nga Sllovenia kryesohej nga Z. Sergej Simoniti, President i Këshillit të Ekspertëve njëkohësisht Drejtor i Agjencisë së Mbikëqyrjes së Sigurimeve të Sllovenisë dhe lektorë ishin Z. Igor Corossi, përfaqësues i Assicurazioni Generali S.p.A. dega Angli dhe Z. Gorazd Jenko, përfaqësues i TRIGLAV Insurance Company Ltd, Slloveni.

Drejtorja e Përgjithshme Ekzekutive e AMF-së, Znj. Enkeleda Shehi, gjatë fjalës së saj përshëndetëse e vuri theksin në forcimin e bashkëpunimit ndërmjet dy rregullatorëve për të rritur kapacitetet e brendshme të AMF-së. Ky bashkëpunim theksoi Znj. Shehi do të shërbejë që stafet profesionale të dy institucioneve të jenë në gjendje të trajtojnë me efektshmëri çështje komplekse për t’iu përshtatur zhvillimit të tregut të sigurimeve. Znj. Shehi theksoi se ky bashkëpunim do të shërbejë edhe në rritjen e kapaciteteve profesionale të drejtuesve dhe profesionistëve të tregut, për të kuptuar më mirë se si funksionon sigurimi i përgjegjësisë që institucionet financiare që AMF mbikëqyr dhe rregullon, të operojnë në mënyrë të sigurt dhe të shëndetshme për të përmirësuar funksionimin e tregut të sigurimeve dhe ofruar shërbime me cilësi të lartë për konsumatorët.



Gjatë zhvillimit të seminarit “Sigurimi i Përgjegjësisë Profesionale”

Ky bashkëpunim theksoi Znj. Shehi do të shërbejë që stafet profesionale të dy institucioneve të jenë në gjendje të trajtojnë me efektshmëri çështje komplekse për t’iu përshtatur zhvillimit të tregut të sigurimeve.

○ ○ ○
Në takim u paraqitën
informacionet dhe
mundësitë që ofrojnë me
skemat e tyre edhe
drejtuesit e të tri
shoqërive administruese
të fondeve të pensionit që
veprojnë në Shqipëri
○ ○ ○

Disa nga temat kryesore që u trajtuan në seminar lidheshin me:

- Bazat e sigurimit të përgjegjësisë;
- Llojet e mbulimit;
- Zhvillimin e produkteve dhe vendosjen e çmimeve;
- Aspektet ndërkombëtare;
- Risigurimin e Përgjegjësisë Profesionale.

Qëllimi i seminarit ishte përfitimi sa më shumë nga eksperiencia Sllovene dhe ajo ndërkombëtare për sa i përket sigurimit të përgjegjësisë në përgjithësi dhe asaj profesionale në veçanti. Pjesëmarrësit kuptuan se cilat janë produktet potenciale të cilat mund të zhvillohen në tregun vendas, duke pasur parasysh ekspozimet ndaj risqeve të ndryshme në tregjet më të zhvilluara dhe çfarë mund të përmirësojnë, me qëllim që t'i shërbejnë më mirë konsumatorëve.

Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare, me mbështetjen e Bankës Botërore, organizoi seancat informuese mbi mundësitë e zgjerimit të sistemit të pensioneve vullnetare në Shqipëri

Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare me mbështetjen e Bankës Botërore zhvilloi në Tiranë, në datën 16 dhe 18 mars 2016 seancat informuese mbi mundësitë e zgjerimit të sistemit të pensioneve vullnetare në Shqipëri. Pjesëmarrës në këto seanca informimi ishin punëdhënës nga kompanitë e ndryshme private që veprojnë në Shqipëri dhe grupe profesionistësh, të cilët mund të jenë pjesëmarrës në këto skema të pensioneve vullnetare.



Gjatë zhvillimit të seancave informuese mbi mundësitë e zgjerimit të sistemit të pensioneve vullnetare në Shqipëri.

Gjatë seancave të informimit eksperti i Bankës Botërore, Z. Leendert van Driel prezantoi mënyrën e funksionimit të sistemit të pensioneve dhe përparësitë që ofron pjesëmarrja në skemat e pensioneve private vullnetare. Në takim paraqitën informacionet dhe mundësitë që ofrojnë me skemat e tyre edhe drejtuesit e të tri shoqërive administruese të fondeve të pensionit që veprojnë në Shqipëri, Raiffeisen Invest-Shoqëri Administruese e Fondeve të Pensionit

○○○
Synimi i këtij takimi ishte informimi më i gjerë dhe dhënia e disa praktikave më të mira në mbulimin e lajmeve për sistemin e pensioneve vullnetare krahasuar edhe me raportime të vendeve të tjera evropiane.
○○○

dhe Sipërmarrjeve të Investimeve Kolektive sh.a., Shoqëria Administruese e Fondeve të Pensionit Sigal-Life Uniq Group Austria sh.a. dhe Shoqëria Administruese e Fondeve të Pensionit SiCRED sh.a. Drejtuesja e Burimeve Njerëzore të kompanisë Vodafon Albania, një kompani e cila i ka të përfshirë punonjësit e saj në skemat e pensioneve vullnetare, pasqyroi eksperiencat e kësaj kompanie, komunikimin dhe marrëdhëniet e ndërtuara me punonjësit pjesëmarrës në fondet vullnetare të pensioneve. Ekspertët e AMF-së prezantuan edhe lehtësirat ligjore, sidomos ato lidhur me sistemin e taksimit, që kanë hyrë në fuqi në fillim të vitit 2015, si edhe ndryshimet ligjore që AMF po propozon për të krijuar sa më shumë lehtësi për punonjësit pjesëmarrës në skemat e pensioneve private. Pjesëmarrësit në seancat e informimit bënë pyetje dhe kërkuan informacione të ndryshme lidhur me mundësitë që ofrojnë këto skema të pensioneve private vullnetare.

Po në kuadër të këtij projekti, AMF organizoi një takim informues edhe me gazetarë të mediave të shkruara dhe vizive që mbulojnë lajmet ekonomike. Synimi i këtij takimi ishte informimi më i gjerë dhe dhënia e disa praktikave më të mira në mbulimin e lajmeve për sistemin e pensioneve vullnetare krahasuar edhe me raportime të vendeve të tjera evropiane.

Këto seanca informimi ishin pjesë e një projekti më të gjerë që po zbatohet nga AMF në kuadër të përmbushjes së rekomandimeve të Programit të Vlerësimit të Sektorit Financiar (FSAP) dhe me mbështetjen e Bankës Botërore, nëpërmjet First Initiative (*Financial Sector Reform and Strengthening Initiative*), i cili krahas zgjerimit synon edhe asistencën teknike për mbikëqyrjen efektive të tregut të pensioneve vullnetare private në vend.

Seminar “Mbi standardet ndërkombëtare për aftësinë paguese dhe kapitalin për siguruesit”

Në datat 1-3 mars në Bazel, Zvicër, u zhvillua seminari “Mbi standardet ndërkombëtare për aftësinë paguese dhe kapitalin për siguruesit”. Seminari u organizua nga Instituti i Stabilitetit Financiar (FSI) dhe kishte pjesëmarrës nga institucionet mbikëqyrëse të shteteve të ndryshme.

Prezantuesit në këtë seminar ishin drejtues dhe ekspertë të njohur të institucioneve financiare apo universiteteve nga vende të zhvilluara si Autoriteti Gjerman i Mbikëqyrjes Financiare (BaFin), Banka e Anglisë, Imperial College, Londër, Instituti & Fakulteti i Aktuarëve, Londër. Ata pasqyruan eksperiencat e tyre në lidhje me mbikëqyrjen në sigurime.

Në seminar u shkëmbyen informacione mbi praktikën dhe eksperiencat e autoriteteve të ndryshme financiare.

Temat që u trajtuan gjatë seminarit ishin:

- Standardet globale mbi mjaftueshmërinë e kapitalit – një qasje me tre shtresa;
- Vlerësimi i provigjoneve teknike dhe IFRS 4;
- Kërkesat e kapitalit për G-SIIs: BCR dhe HLA;
- Perspektiva aktuariale mbi menaxhimin e kapitalit dhe riskut;
- Kapitali ekonomik dhe rëndësia e përcaktimit të mirë ndaj riskut si dhe të proceseve të qëndrueshme të administrimit të riskut;
- Vetëvlerësimi i një siguruesi mbi mjaftueshmërinë e kapitalit duke përdorur një model risku të integruar;
- Risku i modelimit: guximi për të hapur kutinë e zezë;
- Adresimi i gjykimeve eksperte ndaj shqyrtimit të saktë;
- Aftësia paguese në praktikë sipas modelit me bazë risku, shembuj testesh mbi Swiss (SST).

Në seminar u shkëmbyen informacione mbi praktikën dhe eksperiencat e autoriteteve të ndryshme financiare.

Çeki

www.xprimm.com

Të dhënat e tregut të sigurimeve për vitin 2015, të publikuara nga Banka Kombëtare Çeke (CNB) konfirmojnë rritjen e primeve të shkruara bruto në segmentin e sigurimeve të Jo-Jetës, me një ritëm rritjeje prej 4.9%, duke arritur në 90.98 miliardë CZK (Korona Çeke) apo rreth 3.37 miliardë euro. Primet e shkruara bruto të sigurimit të Jetës u ulën me 12.3% gjatë viti 2015. Ndërkohë, i gjithë tregu regjistroi një rënie prej rreth 3%, krahasuar me vitin e kaluar, duke arritur në rreth 5.67 miliardë euro.

Vlerësimi i lehtë i Koronës Çeke në krahasim me euron gjatë vitit 2015 influencoi në mënyrë të konsiderueshme normat e rritjes së tregut të llogaritura në monedha të ndryshme, duke treguar një dinamikë më të mirë për shifrat në monedhën evropiane.

Hungari

www.xprimm.com

Sipas të dhënave paraprake të publikuara nga Banka Kombëtare e Hungarisë (NBH), siguruesit hungarezë e mbyllën vitin 2015 me një volum të përgjithshëm të primeve të shkruara bruto prej 2.72 miliardë euro, rreth 2.67% më shumë sesa vitin e kaluar. Në monedhën vendase, primet e shkruara bruto në total arritën në 851.43 miliardë HUF (monedha vendase Forinta), rreth 2.72 miliardë euro, ose 2.1% më shumë sesa vitin e kaluar. Numri total i kontratave u rrit me 5.8% krahasuar me vitin e kaluar. Kontratat e reja shtesë janë kryesisht rezultat i rritjes në sigurimet e Jo-Jetës, ndërkohë që numri i kontratave të sigurimit të Jetës ka qëndruar i njëjtë. Primet e shkruara bruto të sigurimit të Jetës pësuan një rënie prej 3.2% në krahasim me vitin e kaluar, ndërkohë që primet e sigurimit të Jo-Jetës u rritën me 8.5%. Sigurimi i Jetës ende përfaqëson pjesën më të madhe të portofolit të tregut, me 52% të primeve të shkruara bruto.

Gjatë vitit 2014 dëmet e paguara u rritën me 3% duke arritur një total prej 528.5 miliardë HUF, ose rreth 1.68% thuajse plotësisht të nxitura nga shpenzimet në rritje të dëmeve të paguara për linjat e sigurimit të Jo-Jetës (+7% në krahasim me vitin e kaluar).

Mali i Zi

www.xprimm.com

Primet e shkruara bruto, në tregun e sigurimeve të Malit të Zi patën një rritje prej 6.24% në krahasim me vitin e kaluar, duke arritur në 76.9 milionë euro. Segmenti i sigurimeve të Jo-Jetës kishte kontributin më të madh në rritjen e tregut, duke raportuar prime të shkruara bruto prej 64 milionë euro, ose 6.93% më shumë se në vitin 2014. Linjat e sigurimit të Jo-Jetës llogariten në 83.2% të primeve të shkruara bruto në total.

Normat më të larta të rritjes u raportuan për portofolet e sigurimit të pronës, në mënyrë të veçantë për portofolet e “Dëmeve në pronë”, e cila njohu një rritje të primeve të shkruara bruto prej thuajse 52%. Portofoli “Zjarri dhe rreziqe të lidhura me të” regjistroi gjithashtu një zhvillim pozitiv, me rritje të primeve të shkruara bruto që shkojnë deri në 6.6% në krahasim me vitin e kaluar. Megjithatë, volumi total i primeve të shkruara për këto linja biznesi mbetet i ulët, në rreth 10.44 milionë euro. Segmenti i sigurimit të mjeteve motorike regjistroi një zhvillim të lehtë pozitiv, duke sjellë rritjen e primeve të shkruara bruto me rreth 1% krahasuar me vitin 2014. Burimi kryesor i rritjes ishte sigurimi Kasko, primet e të cilit u rritën me 7% krahasuar me vitin e kaluar.

Poloni

www.xprimm.com

Vlera totale e primeve të shkruara bruto nga siguruesit polakë në vitin 2015 arriti në 54.8 miliardë PLN (monedha vendase Zloti) ose 12.86 miliardë euro, volum ky që ishte thuajse i barabartë me vitin 2014, duke shënuar një ulje 0.23%. Vlera totale e dëmeve të paguara u ul me 2%, duke arritur në 34.8 miliardë PLN, rreth 8.18 miliardë euro. Primet e shkruara bruto të Jo-Jetës patën një rritje prej 3.9% në krahasim me vitin e kaluar, duke arritur në 27.27 miliardë PLN, rreth 6.41 miliardë euro. Rritja e tyre u nxit në mënyrë të konsiderueshme nga rritja e volumit të primeve të risigurimit. Nga ana tjetër, sigurimi i Jetës regjistroi edhe një herë një tendencë negative, me ulje të primeve të shkruara bruto me 3.97%.

Sipas të dhënave të Autoritetit Rumun të Mbikëqyrjes Financiare, tregu rumun i sigurimeve, në fund të vitit 2015 arriti një vlerë të primeve të shkruara bruto prej 1.97 miliardë euro, rreth 8.22% më shumë se vitin e kaluar. Këto shifra totale përfshijnë primet e shkruara bruto edhe nga kompania ASTRA në gjysmën e parë të vitit 2015, përpara fillimit të procedurave të falimentimit të kompanisë. Pa marrë parasysh rezultatet e ASTRA-s, për të dyja vitet 2015, rritja e tregut në vitin 2015 ishte 14.3% në krahasim me vitin 2014.

Tregu rumun është ende larg pikut historik të regjistruar në vitin 2008 me një shifër totale të volumit të primeve të shkruara bruto prej 2.4 miliardë euro.

Gjatë vitit 2015 sigurimi i Jetës ka regjistruar një rritje totale të volumit të primeve të shkruara bruto prej 10.8%, duke arritur në 408.1 milionë euro. Produktet e sigurimit të Jetës të lidhura me skemat e investimit njohën rritjen më të lartë të primeve të shkruara bruto prej 2.8%.

Gjatë vitit 2015, primet e shkruara bruto të Jo-Jetës u rritën me 7.5%, duke arritur në 1.56 miliardë euro. Kjo rritje është mbështetur kryesisht nga linjat e sigurimit MTPL, të cilat njohën një rritje dyshifrore të primeve të shkruara bruto me 17.44%, duke arritur në 739.9 milionë euro. Edhe sigurimi Kasko njohu një trend disi pozitiv, me prime të shkruara bruto të cilat u rritën me 0.2%, krahasuar me vitin 2014, duke arritur në 379.67 milionë euro. Rritja me 15% e çmimeve në shitjet e makinave të reja, gjatë vitit 2015 është sigurisht një nga nxitësit kryesorë të rritjes së primeve të shkruara bruto, krahas rritjes së tarifave MTPL.

Sipas të dhënave të publikuara nga Shoqata Sllovene e Sigurimeve, tregu vendas u mbyll në vitin 2015 me prime të shkruara bruto prej 1.9 miliardë euro, 1.95% më shumë se vitin e kaluar. Sigurimi i Jetës njohu një rritje më të lartë se mesatarja, prej 5.7%, duke arritur në 28.65% të totalit të tregut.

Megjithëse trendi i përgjithshëm në sigurimin e Jo-Jetës ishte lehtësisht pozitiv, primet e shkruara bruto për linjat e sigurimit të mjeteve motorike, (sigurimi Kasko dhe MTPL) shënuan një ndryshim negativ duke zbritur me më shumë se 2%.

IOSCO “Vështrim mbi risqet në tregun e letrave me vlerë, 2016”

www.iosco.org

Organizata Ndërkombëtare e Komisioneve të Letrave me Vlerë (*International Organization of Securities Commissions, IOSCO*) publikoi më 2 mars 2016 botimin “Vështrim mbi risqet në tregun e letrave me vlerë, 2016” (*Securities Markets Risk Outlook 2016*).

Ky botim identifikon dhe shqyrton tendencat kryesore globale në tregjet financiare dhe rreziqet e mundshme ndaj stabilitetit financiar. Synimi i këtij botimi kalon edhe më gjerë duke përfshirë edhe dy objektiva të tjerë kryesorë të IOSCO-s, mbrojtjen e investitorit dhe efikasitetin e tregut.

Realizimi i këtij botimi është lehtësuar edhe nga rritja e të dhënave mbi tregjet e letrave me vlerë, përfshirja e studimeve dhe kërkimeve nga ekspertët dhe akademikët. Gjithashtu informacionet janë plotësuar edhe nga një anketim i zhvilluar në periudhën mars-prill 2015.

Botimi “Vështrim mbi risqet në tregun e letrave me vlerë, 2016” identifikon katër fusha potenciale të rezikut:

1. Likuiditeti i letrave me vlerë të korporatave (*Corporate bond market liquidity*);
2. Risqet e lidhura me përdorimin e kolateralit në transaksionet financiare (*Risks associated with the use of collateral in financial transactions*);
3. Sjelljet e dëmshme gjatë tregtimit / apo shitjes së produkteve dhe shërbimeve financiare
4. Kërcënimet kibernetike (*Cyber threats*).

Për të lexuar të plotë këtë botim klikoni <http://www.iosco.org/library/pubdocs/pdf/IOSCOPD527.pdf>

Synimi i këtij botimi kalon edhe më gjerë duke përfshirë edhe dy objektiva të tjerë kryesorë të IOSCO-s, mbrojtjen e investitorit dhe efikasitetin e tregut.

EIOPA publikon qasje makroprudenciale, në mjedisin me norma të ulta interesi në kushtet e regjimit *Solvency II*

www.eiopa.europa.eu

Autoriteti Evropian i Sigurimeve dhe Pensioneve Profesionale (*European Insurance and Occupational Pension Authority, EIOPA*) publikoi në mars 2016 botimin lidhur me mundësitë e qasjes makroprudenciale në mjedisin me norma të ulta interesi në regjimin *Solvency II* “(*EIOPA macroprudential approach to the low interest rate environment in Solvency II*)”.

Ky botim synon të kontribuojë në diskutimin për nevojën e mundshme të zhvillimit të një kuadri makroprudencial në sektorin e sigurimeve për të promovuar stabilitetin financiar në kushtet e zbatimit të *Solvency II*.

Në botim trajtohen tre objektiva të cilat autoritetet mbikëqyrëse duhet t'i kenë në qendër të vëmendjes në mjedisin aktual me norma të ulta të interesit, siç janë:

1. Rritja e elasticitetit të sektorit të sigurimeve. (*Increasing the resilience of the insurance sector*);
2. Kufizimi i sjelljeve të rrezikshme të siguruesve që kolektivisht kërkojnë fitim”(*Limiting risky behaviour of insurers collectively “searching for yield”*);
3. Shmangia e tendencave prociklike (pra luhatjeve në përputhje me tendencat në ciklin ekonomik) (*Avoiding procyclicality (i.e. fluctuation in line with the trend in the economic cycle)*).

Për secilën nga këto tri objektiva EIOPA përcakton një sërë instrumentesh që janë pjesë ose janë në përputhje me *Solvency II*. Më tej, botimi përshkruan veprimet afatshkurtra dhe afatmesme që mund të ndërmarrin si EIOPA ashtu edhe mbikëqyrësit kombëtarë për të vepruar në mjedisin me norma të ulta interesi.

Për të lexuar të plotë këtë botim klikoni <https://eiopa.europa.eu/Publications/Opinions/EIOPA-BoS-15-202%20A%20macroprudential%20approach%20to%20LIR%20in%20SII.pdf>

Ky botim synon të kontribuojë në diskutimin për nevojën e mundshme të zhvillimit të një kuadri makroprudencial në sektorin e sigurimeve për të promovuar stabilitetin financiar në kushtet e zbatimit të *Solvency II*.



Mbrojtja financiare e konsumatorit duhet të jetë një pjesë integrale e kuadrit ligjor, rregullator e mbikëqyrës dhe duhet të reflektojë diversitetin e rrethanave kombëtare, tregut global dhe zhvillimet rregullatore brenda sektorit financiar.

Parimet e nivelit të lartë të G20 për mbrojtjen e konsumatorit

<http://www.oecd.org/regreform/sectors/financialconsumerprotection.htm>

(pjesa e parë)

Parimet e renditura më poshtë u janë drejtuar anëtarëve të G20 dhe vendeve të tjera të interesuara. Ato janë hartuar si ndihmë në përpjekjet për të rritur mbrojtjen financiare të konsumatorit. Këto parime janë vullnetare dhe të ndërtuara për të plotësuar dhe jo për të zëvendësuar, parimet financiare ndërkombëtare apo udhëzimet ekzistuese. Në veçanti, ato nuk merren me çështje specifike të sektorit të trajtuara nga organizatat specifike ndërkombëtare dhe përcaktuesit e standardeve financiare të tilla si, BCBS, IAIS dhe IOSCO. Transaksione të llojeve të ndryshme, paraqesin profile të ndryshme të rrezikut. Parimet mund të kërkojnë përshtatje në kontekste të veçanta kombëtare dhe sektoriale dhe duhet të rishikohet periodikisht nga organizmat përkatëse ndërkombëtare.

Të gjithë anëtarët e G20 dhe ekonomitë e tjera të interesuara duhet të vlerësojë kornizat e tyre kombëtare për mbrojtjen e konsumatorit financiar në dritën e këtyre parimeve dhe të nxisin bashkëpunimin ndërkombëtar në këtë drejtim.

Këto parime u miratuan në një dokument final për mbrojtjen e konsumatorit dhe u mbështetën nga Ministrat e Financës dhe Guvernatorët e Bankave Qendrore të G20 tek takimi i tyre në tetor 2011.

PARIMET

1. Kuadri ligjor, rregullator dhe mbikëqyrës

Mbrojtja financiare e konsumatorit duhet të jetë një pjesë integrale e kuadrit ligjor, rregullator e mbikëqyrës dhe duhet të reflektojë diversitetin e rrethanave kombëtare, tregut global dhe zhvillimet rregullatore brenda sektorit financiar.

Rregullorja duhet të reflektojë dhe të jetë proporcionale me karakteristikat, llojin dhe shumëllojshmërinë e produkteve dhe konsumatorëve, të drejtat dhe përgjegjësitë e tyre dhe t'u përgjigjet në kohë produkteve, dizenjove, dhe teknologjive¹. Mekanizmat e fuqishëm dhe efikasë ligjorë, gjyqësorë ose mbikëqyrës duhet të ekzistojnë për të mbrojtur konsumatorët me anë të sanksioneve kundër mashtrimeve financiare, abuzimeve dhe gabimeve.

¹ Aty ku është e përshtatshme, duhet të zhvillohen mekanizmat e duhur për të pasur kanale të reja të transmetimit për shërbimet financiare, duke përfshirë shpërndarjen elektronike të shërbimeve financiare, edhe nëpërmjet telefonisë celulare, ndërkohë që ruhen përfitimet e mundshme për konsumatorët.

Ofruesit e shërbimeve financiare dhe agjentët e autorizuar² duhet të rregullohen dhe/ose mbikëqyrren siç duhet, duke marrë në konsideratë shërbimin përkatës dhe përqasjet specifike në sektor.

Grupet jo-qeveritare të interesit, duke përfshirë organizatat e industrisë dhe konsumatorit, organet profesionale dhe komunitetet kërkimore, duhet të konsultohen kur zhvillohen politikat që lidhen me arsimimin dhe mbrojtjen financiare të konsumatorit. Aksesit i grupeve përkatëse të interesit, në mënyrë të veçantë i organizatave të konsumatorit, në procese të tilla duhet të lehtësohet dhe përmirësohet.

2. Roli i organeve të mbikëqyrjes

Duhet të ekzistojnë organe mbikëqyrëse, të dedikuara ose jo, posaçërisht përgjegjëse për mbrojtjen financiare të konsumatorit, me autoritetin e duhur për të përmbushur mandatet e tyre. Ato duhet të kenë përgjegjësi të përkufizuara qartë dhe objektivisht, qeverisjen e duhur; pavarësi operacionale; përgjegjshmëri për aktivitetet e tyre; kompetencat e duhura; burime dhe kapacitete; kuadër të përcaktuar dhe transparent për zbatim dhe procese rregullatore të qarta dhe të qëndrueshme. Organet mbikëqyrëse duhet të zbatojnë standarde të larta profesionale, duke përfshirë standardet e duhura të konfidencialitetit të konsumatorit dhe shmangien e konflikteve të interesit.

Duhet të promovohet bashkëpunimi me autoritetet e tjera mbikëqyrëse të shërbimeve financiare dhe ndërmjet autoriteteve ose departamenteve në ngarkim të çështjeve sektoriale. Duhet të inkurajohen sipas rastit mundësi të barabarta në shërbimet financiare. Gjithashtu, bashkëpunimi ndërkombëtar ndërmjet organeve të mbikëqyrjes duhet të inkurajohet, ndërkohë që vëmendje specifike duhet t'i kushtohet çështjeve të mbrojtjes së konsumatorit, të cilat lindin nga transaksionet ndërkombëtare, marketingu e shitjet ndërkufitare.

3. Trajtimi i barabartë dhe i drejtë i konsumatorëve

Të gjithë konsumatorët financiarë duhet të trajtohen në mënyrë të barabartë, të ndershme dhe të drejtë në të gjitha stadet e marrëdhënies së tyre me ofruesit e shërbimeve financiare. Trajtimi i konsumatorëve në mënyrë të drejtë duhet të jetë një pjesë integrale e qeverisjes së mirë dhe kulturës korporative të të gjithë ofruesve të shërbimeve financiare dhe agjentëve të autorizuar. Vëmendje e veçantë duhet t'i kushtohet nevojave të grupeve vulnerabël.

² Agjentët e autorizuar nënkuptojnë palët e treta që veprojnë për ofruesin e shërbimeve financiare ose si një kapacitet i pavarur. Ata përfshijnë agjentët (agjentët e varur dhe të pavarur), brokerat, këshilltarët dhe ndërmjetësit, etj.

Organet mbikëqyrëse duhet të zbatojnë standarde të larta profesionale, duke përfshirë standardet e duhura të konfidencialitetit të konsumatorit dhe shmangien e konflikteve të interesit.

Konsumatorët duhet të vihen në dijeni për rëndësinë e ofrimit të shërbimeve financiare me informacionet e duhura, të sakta dhe të disponueshme.

4. Dhënia e informacionit dhe transparencia

Ofruesit e shërbimeve financiare dhe agjentët e autorizuar duhet t'u japin konsumatorëve informacionet kryesore që i njoftojnë ata për përfitimet, risqet dhe kushtet themelore të produktit. Ata duhet të japin gjithashtu informacione për konfliktet e interesit që lidhen me agjentin e autorizuar nëpërmjet të cilit shitet produkti.³

Në mënyrë të veçantë, informacioni duhet të jepet për aspektet materiale të produktit financiar. Informacionet e duhura duhet të jepen në të gjitha stadet e marrëdhënies me klientin. Të gjitha materialet promovionale financiare duhet të jenë të sakta, të ndershme, të kuptueshme dhe jo çorientuese. Praktikrat e standardizuara para-kontraktuale për dhënien e informacionit (p.sh. formularët) duhet të miratohen kur është e mundur, për të lejuar edhe mundësinë e krahasimeve ndërmjet produkteve dhe shërbimeve të së njëjtës natyrë.

Mekanizmat specifikë për dhënien e informacionit, duke përfshirë paralajmërimet e mundshme, duhet të zhvillohen për të dhënë informacione mbi produktet dhe shërbimet komplekse dhe me risk. Aty ku është e mundur, kërkimet për konsumatorin duhet të jenë të tilla që të ndihmojnë përcaktimin dhe përmirësimin e efikasitetit e kriterëve për dhënien e informacionit.

Dispozita e këshillimit duhet të jetë sa më objektive që të jetë e mundur dhe përgjithësisht duhet të bazohet në profilin e konsumatorit duke konsideruar kompleksitetin e produktit, risqet që lidhen me të, si dhe objektivat financiare, njohuritë, kapacitetet dhe eksperiencën e klientit.

Konsumatorët duhet të vihen në dijeni për rëndësinë e ofrimit të shërbimeve financiare me informacionet e duhura, të sakta dhe të disponueshme.

³ Ofruesit e shërbimeve financiare dhe agjentët e autorizuar duhet të sigurojnë informacione të qarta, koncize, të sakta, të sigurt, të krahasueshme, lehtësisht të aksesueshme dhe në kohën e duhur, me shkrim dhe me gojë mbi produktet dhe shërbimet financiare të ofruara, në mënyrë të veçantë mbi veçoritë kryesore të produkteve dhe (ku është e nevojshme) mbi shërbimet ose produktet e mundshme alternative, duke përfshirë ato më të thjeshta që ato ofrojnë. Në parim, informacioni duhet të përfshijë çmimet, kostot, penalitetet, tarifat, risqet dhe modalitetet e përfundimit.

The logo for the Albanian Financial Markets Authority (AMF) features the lowercase letters 'amf' in a dark red color, followed by the word 'ALBANIA' in white uppercase letters. The text is set against a light gray background that is divided into two rectangular sections.

amf **ALBANIA**

Për informacion të mëtejshëm
ju lutemi na kontaktoni:

Rr. "Dora D'Istria", Nr. 10 , P.O.Box 8363, Tiranë
Tel: +355 42 251 355/6 | Fax: +355 42 250 686
amf@amf.gov.al | www.amf.gov.al